



Datë: 16.05.2025

Numër protokoli: 3232/2025

A.nr.346/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, si dhe Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.346/2025 të datës 21.02.2025 të parashtruar nga ankuesja A.B, kundër organit të punësimit/Inspektorati i Arsimit-Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike *“kompensim material”*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në pajtim me Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.05.2025, mori këtë;

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa numër A.nr.346/2025 e datës 21.02.2025 e parashtruar nga ankuesja A.B.

II. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshme në Inspektoratin e Arsimit/Ministrinë e Arsimit, Shkencë, Teknologjisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij, që ankueses t'i bëjë kompensimin e pushimit vjetor sipas kërkesave të parashtruara më datë 06.06.2024 dhe 13.11.2024.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, A.B (në tekstin e mëtejme referuar: *Ankuesja*) e punësuar në Inspektoratin e Arsimit/Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me datë 21.02.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1160/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos kompensimin e pushimit vjetor sipas kërkesave të parashkruar më datë 06.06.2024 dhe 13.11.2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.03.2025, 17.04.2025, 29.04.2025 dhe 02.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (tutje MASHTI), mirëpo nuk ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën e datës 21.02.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuses; Kërkesë për kompensim në të holla për 13 ditë të pushimit e datës 29.07.2024 dhe 09.09.2024 e parashtruar nga ankuesja tek u.d. Drejtoresha e Përgjithshme e Inspektoratit të Arsimit; Kërkesën për kompensim në të holla për 47 ditë të pushimit e datës 10.01.2025 e parashtruar nga ankuesja tek u.d. Drejtoresha e Përgjithshme e Inspektoratit të Arsimit; Vendim për pushim vjetor i datës 06.06.2024 dhe 13.11.2024; Kërkesën e datës 10.01.2025 nga ankuesja për u.d. Drejtoresha e Përgjithshme e Inspektoratit të Arsimit për kompensim të pushimit vjetor; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 20.03.2025, 17.04.2025, 29.04.2025 dhe 02.05.2025.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuses, është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesja më datë 06.06.2024 ka parashtruar kërkesë për pushim vjetor për datë 10-28.06.2024 për 14 ditë mirëpo të njëjtës i është refuzuar me arsyetimin për shkak të vëllimit të madh të aktiviteteve dhe punëve të janë në procedurë.

Më datë 29.07.2024 ankuesja ka parashtruar kërkesë tek u.d. Drejtoresha e Përgjithshme e Inspektoratit të Arsimit përmes të cilës ka kërkuar kompensim në të holla për 13 ditë pune të vitit të kaluar për mos shfrytëzimin e pushimit vjetor e të cilën kërkesë e ka përsëritur edhe më datë 09.09.2024, ndërsa më datë 13.11.2024 ka parashtruar kërkesë për pushim vjetor për periudhën nga data 14.11.2024 deri më datë 31.12.2024, mirëpo kërkesa për pushim vjetor i është refuzuar për shkak të angazhimeve në zyre. Ankuesja më datë 10.01.2025 ka parashtruar kërkesë tek u.d. Drejtoresha e Përgjithshme e Inspektoratit të Arsimit përmes të cilës ka kërkuar kompensim në të holla për 47 ditë pune të vitit të kaluar për mos shfrytëzimin e pushimit vjetor, mirëpo që nuk ka marr ndonjë përgjigje.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se organi i punësimit nuk ka miratuar kërkesat për pushim vjetor dhe më është mohuar pushimi vjetor, mirëpo edhe përkundër kësaj ky pushim nuk më është kompensuar me të holla siç përcaktohet me dispozitat ligjore në fuqi. Kërkon që ankesa të aprovohet dhe të bëhet kompensimi financiar për 47 ditë të pushimit vjetor të pashfrytëzuar.

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me këtë çështje ankimore, analizoj bazën ligjore në fuqi lidhur me pushimet vjetor gjerësisht nenin 21, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet: *1. Orari i punës dhe pushimet e zyrtarës/it publik rregullohen në përputhje me legjislacionin përkatës për punë, në ndërlidhje me këtë Kolegji i Këshillit ju referuar nenit 38 paragrafi 1. 2, 3 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, ku thuhet se: “1. Të punësuarit nuk mund t’i mohohet e drejta në shfrytëzimin e pushimit vjetor. 2. I punësuarit që nuk e ka shfrytëzuar pushimin vjetor apo një pjesë të pushimit me fajin e punëdhënësit, ka të drejtë për ta shfrytëzuar atë pushim gjatë periudhës vijuese e cila i konvenon punëmarrësit, apo kompensim me të holla.3. Lartësia e kompensimit nga paragrafi 2. i këtij neni, caktohet varësisht nga kohëzgjatja e pushimit vjetor të pashfrytëzuar sipas të ardhurave të cilat i punësuarit i realizon për muajin kur kompensohet”,* prandaj bazuar në përcaktimin ligjor dhe nga shkresat e lëndës del se ankueses pushimi vjetor për periudhën e cekur si më lartë i është refuzuar nga institucionit për shkak të vëllimit të punëve dhe angazhimit në zyre, respektivisht ankuesja pushimin vjetor për periudhë e cekur si më lartë nuk e ka shfrytëzuar për shkak të fajin e punëdhënësit. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, vlerëson se në rastet e tilla nëpunësi ka të drejtë të kërkojë që kompensimi i pushimit vjetor të pashfrytëzuar të bëhet në të holla, andaj përkitazi me konstatimin si më sipër Kolegji i Këshillit konstaton se organi i punësimit respektivisht Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit është i obliguar që në pajtim me nenin 38 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ankueses t’i bëjë kompensimin e pushimit vjetor të pashfrytëzuar sipas kërkesave për pushim vjetor të datës 06.06.2024 dhe 13.11.2024.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.346/2025

Avdyl Bekteshi

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Procesmbajtës

Kryetarja e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses A.B;*
- *Drejtorit të Përgjithshme në Inspektoratin e*
Arsimit-Ministria e Arsimit, Shkencë, Teknologjisë dhe Inovacionit; dhe
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*